



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**  
**NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**

“TRING TV” SH.A. Dega në Kosovë  
Pronar: “Tring TV” SH.A.  
OSHP “3 PLUS”  
Rr. Luan Haradinaj nr. 19/3  
Prishtinë

Vendimi LIC/OSHP-KKPM: 2013/06  
Ref:1301/192/KPM/ni

**VENDIM**

*lidhur me licencimin e ofruesit të shërbimeve programore “3 PLUS” - Prishtinë*

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për distribuimin kabllor të programeve radiotelevizive në Kosovë (CIMC 2007/04) ka hyrë në fuqi më 06.07.2007, ndërsa, në bazë të Nenit 16 të Rregullores CIMC 2007/04, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore, të cilët do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore e të cilat programe do të transmetohen vetëm përmes operatorëve kabllorë.
3. Më 30 qershor 2011 kandidati për Ofrues të Shërbimeve Programore “3 PLUS” ka paraqitur në KPM aplikacionin për Licencë të KPM-së.

**Arsyetim**

4. Në bazë të nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore do të rregullohen sikurse subjektet transmetuese.
5. Kandidati për licencë të KPM-së “3 PLUS” në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhëna për Licencë të KPM-së, për të ofruar shërbime programore dhe në pajtueshmëri me Nenin 16 të Rregullës CIMC 2007/04 ofruesi i shërbimeve programore “3 PLUS”, mirpo nuk i ka paraqitur të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së.
6. Komisioni i KPM-së vlerëson se kandidati “3 PLUS” nuk ka ofruar informacione të mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit, të cilat mund të konsiderohen si informacione bindëse lidhur me skemën programore në përgjithësi, duke paraqitur një strukturë të qartë organizative, informacione rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve programore.

7. Në pajtim me nenin 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore "3 PLUS" do të veprojnë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
8. Komisioni i KPM-së vlerëson se ofruesi i shërbimeve programore "3 PLUS" nuk i ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

### Vendim

9. Komisioni i KPM-së konkludon se "3 PLUS" ka aplikuar për licencë të KPM-së mirpo nuk ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve përmes sistemit kabllor.
10. Komisioni i KPM-së vendosë që, ofruesit të shërbimeve programore "3 PLUS", me seli në Prishtinë, t'i refuzoj kërkesën për licencën e KPM-së për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore në Republikën e Kosovës.
11. Kandidati për Ofrues të Shërbimeve Programore, "3 PLUS", ka të drejtë që në të ardhmen të aplikoj përsëri për licencë të Ofruesit të Shërbimeve Programore, duke dorëzuar aplikacion të ri dhe të kompletuar, në zyrën e KPM-së.

### Lëshimi i Vendimit

12. Këtë vendim e lëshon KPM.

  
Shafki Ukaj  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur për Media.



28.12.2012  
Data